Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1060

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani -Kryetar duke vendosur sipas ankesës së (OE) N.N "Bli Term" kundër Vendimit për dhënie të një kontrate Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Vlerësim i riskut në vendin e punës 23-10480-2-3-6" me 21/03/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE N.N "Bli Term" me nr. 2023/1060, kunder Vendimit të Autoritetit kontraktues- Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A, Komuna Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Vlerësim i riskut në vendin e punës 23-10480-2-3-6."

2. Anulohet "Njoftim mbi Venbdim të Autoritetit Kontraktues" për dhënie të kontratës i datës 11.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Vlerësim i riskut në vendin e punës 23-10480-2-3-6" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – K. Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A, dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.10.2023, K. Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ri-

Vlersimi i riskut në vendin e punës 23-10480-2-3-6".Ndërsa me datën 11.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "NMA Sh.P.K"Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 9,200.00 €.

Me 15.12.2023, OE N.N "Bli Term" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 19.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 28.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.N "Bli Term" me nr. 1060/23 për lidhur me aktivitetin "Ri-Vlerësim i riskut në vendin e punës 23-10480-2-3-6".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N "Bli Term" janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I):Ankuesi pretendon: "Pretendimi 1 (4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale) ne Dosjen e Tenderit kërkohet Ekspert të Kimisë Minimum një (1) ku ne këtë kërkese OE paraqitur Teknolog industrial ne vend të Ekspertit të Kimisë – nuk është relevant Me kërkesën) edhe pas kërkesës për sqarim nga Ak OE nuk është qe ka dhënë një sqarim bindes për plotësimin e këtij kriteri."

Pretendimi i dytë (II): "Minimum një (1) Ekspert për mbrojtje nga zjarri i certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) i profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve sipas Udhëzimit Administrativ NR.10 2018. Në këtë pike OE ka paraqitur Person të diplomuar ne menagjimin e arteve te emergjencave, ky drejtim nuk përgjigjet shkencave teknike sipas kërkesës ne dosjen e tenderit ? Edhe pas pyetjes sqaruese nga AK, OE nuk jep sqarim por arsyetohet qe AME vendos që kush i plotëson kushtet për certifikim e kush jo, kjo përgjigjeje është arrogante dhe injoruese, duke e kontestuar edhe vete AK-ne ne këtë rast duke i bërë qe të ndjehen te pa informuar në kitë rast, kur në bazë te Ligjit të Prokurimit gjithçka duhet të jete brenda Kërkesave te paraqitura ne Dosjen e Tenderit në këtë rast bëhet shkelje e Nenit te 27-të të LPP-së. Dhe AK është dashur që ta eliminoj që në fillim pa kërkuar as sqarim shtese në këtë pike. Bazuar ne programet certifikuese ne universitete/kolegje Erasmus Subject Codes – Sipas programeve Erasmus programet akreditohen ne kolegje. Nuk plotësohet kriteri I kërkuar edhe pas kërkesës për sqarim."

Pretendimi i tretë (III) : "Licencë valide nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ofrimin e shërbimeve nga Siguria dhe Shëndeti në Punë, komform Rregullores Nr. 01 2021. 4. Licenca për Certifikimin e stafit profesional për SSHP 5. Autorizimi për hartimin e projekteve kundër zjarri nga AME 6. Autorizimi për trajnim për mbrojtje nga zjarri nga AME."

Pretendimi i katërt (IV) : “Minimum një (1) Ekspert të Arkitekturë Minimum Ne këtë rast OE ka Ofruar Inxhinieren Lirdona Berisha, dhe është njëra nga pikat më kryesore që AK duhet të kete parasysh pasi që Inxhiniere e Arkitekturës nuk ishte ne dijeni për marrëveshje ne këtë Projekt, dhe l:nda duhet te procedohet si përdorim i Dokumenteve pa autorizim te personit përgjegjës, dhe Ne Rekomandojmë Ak, që të marr informacione shtese edhe nga Arkitektja në fjalë, dhe menjëherë të nis proceduara ligjore për këtë shkelje e cila cilësohet si Vepër Penale. Iu Ofrojmë edhe faktet si me poshtë që dokumentet e Liridona Berisha janë të përdoruara pa autorizim dhe pa dijeni te personit në fjalë.”

Pretendimi i pestë (V) : “Ne si OE e konsiderojmë veten si të diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër N.N “Bli Term” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1, 2, 7, 27, 59, 64, 66 të LPP-së. Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr; Vendim që të Aprovohet, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE :N.N “Bli-Term” Anulohet, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në Rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së..

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: “Lidhur me te gjitha pretendimet e juaja ne lidhje me procedurën e prokurimit “Ri-Vlerësimi i riskut në vendin e punës 23-10480-2-3-6”, K K. Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A konsideron se te gjitha pretendimet e juaja jane ta pabazuara.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1060/23, ndërsa me datë 09.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1060 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është Përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, po ashtu edhe OE nuk është përgjigjur me mendimin e ekspertit.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Vlerësimi i pretendimeve ankimore të OE N.N “Bli Term” nga eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/971 si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Ne baze te kriterit te dosjes për kuotim te çmimit AK-ja ka kërkuar Ekspert të Kimisë Minimum një (1) këtu eksperti shqyrtues konstaton se AK-ja nuk ka cekur ne kriter çfarë drejtimi, dege apo profile por vete ekspert te kiminis qe i bije se OE i rekomanduar ka plotësuar kushtet. Duke u bazuar ne këtë te cekur me lart unë si ekspert konkludoj se AK-ja ne kriteret tjera e ka profilizuar drejtimin, degën si shembull (Ekspert të Makinerisë – Komunikacion) e ka profilizuar ndërsa ne rastin e ekspertit te Kimisë nuk ka cekur se cilës dege duhet te jete (mos profilizimi i drejtimit apo degës AK-ja ndoshta e ka bere për mos kufizim te konkurrencës). Gjithashtu OE ankues nuk ka jep dëshmi – fakte qe Kimia Industriale nuk mundet me qene ekspert te kimisë apo nuk ka jep fakt se kompania e rekomanduar nuk e ka përmbushur kushtin për ekspert te kimisë, unë si eksperti konstatoj se Ramadan Basha qe është i diplomuar si Kimist Industrial me studime pesë vjeçare është i certifikuar si Ekspert për siguri dhe shëndet ne pune nga Ministria e Financave sipas ligjit ne fuqi te cekur ne dosjen e kuotimit dhe certifikata e tije ka afat deri 31 mars 2028 , ne baze te kësaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.”

Konstatimi i dytë (II): “Ne këtë pretendim ankimor lidhur me Ekspert për mbrojtje nga zjarri i certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) i profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve unë si ekspert konstatoj se kompania “NMA ShPK “ e rekomanduar për kontrate ka paraqitur ne oferte z. Valon Ajazin si ekspert me certifikate për mbrojtje nga zjarri te lëshuar nga AME-ja, por nuk është i diplomuar nga shkencat teknike z. Ajazi siç ka qene kërkesa e dosjes se tenderit. Mirëpo me pyetjen sqarues qe e ka bere AK-ja drejtuar OE te rekomanduar për kontrata "NMA" ShPK ka cekur se ne e kemi personin tjetër qe është i certifikuar nga shkencat teknike z. Driton Çaka si Ekspert për mbrojtje nga zjarri i certifikuar nga AME qe ne baze te kësaj mundem me konstatuar unë si ekspert se pretendimi është pjesërisht i bazuar pasi me anëtarin tjetër e ka plotësuar kriterin e vlerësimit te dosjes se tenderit kompania e rekomanduar Z. Çaka është i certifikuar për mbrojtje nga zjarri i certifikuar nga AME. Duke e analizuar këtë aktivitet te prokurimit si ekspert mendoj se ky aktivitet i prokurimit është kuotim i çmimit dhe sipas LPP-se dhe RRPP 82/2022 kjo procedure zgjidhet kur ka treg te mjaftueshëm te OE dhe mendohet ne fakt qe ofertojnë vetëm ato kompani qe merren me shërbime qe do te kuotojnë çmimet e tyre , ne këtë rast mundem me konkluduar se ne kuotime te çmimeve nuk duhet te kërkohen kritere te vlerësimit shume pasi mendohet se ka treg e ne këtë rast sa i përket kriterit për (Ekspert për mbrojtje nga zjarri i certifikuar nga AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës) i profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve) duhet te konsiderohet si devijim i vogël pasi OE I rekomanduar e ka edhe një person tjeter nga stafi qe ka dorëzuar me oferte. Ne baze te ligjit me lejohet te jepi një konkludim, ateher AK-ja -Uniteti Sh.a Mitrovice mendoj se ka kërkuar shume kritere për vlerësim dhe është kufizuar konkurenca ne baze te asaj qe kane zgjedhur procedure kuotimin e cmimit. AK duhet ti beje vlerësimin e certifikatat ne baze te nenit 59 te LPP-se dhe ne baze te nenit 69 pasi ne dosjen e tenderit është kërkuar certifikatat dhe ne baze te nenit 69 mundet te ketë sqarime . Po e citojm nenin . Në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nenë.

Konstatimi i tretë (III) : “Pretendimi 3 nuk ka cek fakte as dëshmi.”

Konstatimi i katërt (IV): “Ne baze te fakteve dhe dëshmive qe ka oferuar kompania ankues “N.N. Bli Term” ne aknes shifet se Liridona Berisha nuk është pjese e stafit te kompanisë se rekomanduar “NMA” shpk. Ne baze te fakteve kompania e rekomanduar për kontrate ka deklaruar informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese për AK-ne . Nëse një OE dorëzon dokumente qe ka përmbajtje mashtruese ose deklarata te gabueshme ne baze te ligjit te Prokurimit duhet te eliminohet ose sanksionohet ne këtë rast konstatoj se pretendimi është bazuar. Eksperti konstaton, Liridona Berisha është përgjigjur ne Emaill 14.12.2023 dhe ka cekur. po e citoj: ndërsa sa i përket aktivitetit te prokurimit me titull Ri-Vlerësimi i riskut në vendin e punës nga K. Regjionale e mbeturinave “Uniteti” Sh.A si qe e keni cekur ju, unë nuk Posedoj kontrate as marrëveshje për aplikim/realizimin e procedurave te këtij aktivitetit, te cilin do ta verifikoj ne procedurat e mëtejme mbi shkeljet e mundeshme. Faleminderit shume përsëri për informimin lidhur me këtë rast. Mbarim citati. Gjithashtu AK-ja duhet ti vërtetoj faktet e kompanis Ankuese “N.N. Bli Term” lidhur me Liridona Berisha dhe te eliminoj kompaninë “NMA shpk” nga gara. Autoriteti Kontraktues “Uniteti” sh.a Mitrovice ka bere shkelje te nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik duke E rekomanduar për dhënje te kontratës operatorin ekonomik “NMA shpk” edhe pse oferta e tij nuk është e përgjegjshme bazuar ne kriteret dhe kërkesat e dosjes tenderit.”

Konstatimi i pestë (V) : “Eksperti shqyrtues konstaton se gjate fazës se vlerësimit te ofertave AK-ja nuk e ka bere vlerësimet e ofertave ne përputhje me nenin 59 te LPP-së pasi nuk janë sqaruar gjitha dyshimet e OE te rekomanduar NMA ShPK qe parasheh nenin 59 e ne baze te kësaj mundem me konkluduar se ka pasur diskriminim gjate fazës se vlerësimit te ofertave e AK-ja do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar diskriminimin. Gjithashtu ne fazën e kërkesës për rishqyrtim AK-ja “Unitetit”sh.a Mitrovice nuk i ju është përgjigjur ne pretendimet ankimore qe i ka pas OE ankues dhe ne baze te kësaj eksperti konstaton se është shkelur komplet nenin 108A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve qe ne baze te përgjigjes qe ju është dërguar është jo profesionale.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N “Bli Term”. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N “Bli Term” janë të bazuara.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe

parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Vlerësim i riskut në vendin e punës 23-10480-2-3-6."

Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N "Bli Term" dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N "Bli Term" janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ri-Vlerësimi i riskut në vendin e punës 23-10480-2-3-6", të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës

konkrete dhe dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit "Ri-Vlerësimi i riskut në vendin e punës 23-10480-2-3-6" " të rivlerësohet AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LLP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin, faktet e lartë përmendura, ankesën e operatorit ekonomik ankues, dokumentacionit të lëndës, pas analizimi te tyre e vlerëson ankesën e operatorit si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me titull "Ri-Vlerësimi i riskut në vendin e punës" të kthehet në Rivlerësohet dhe Autoriteti kontraktues, të veproj për evitimin e gjitha shkeljeve ligjores, përkatësisht të pretendimeve ankimore të OE "Bli Term" të vlerësuara si të bazuara/qëndrueshme sipas Raportit të ekspertit shqyrtues, konstatime të cilat janë të mbështetura nga Paneli shqyrtues, me dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e nenit, 59 dhe 69të LPP-së, dhe Autoriteti kontraktues obligohet që në procesin e Rivlerësimit t'i eliminojnë të gjitha këto shkelje ligjore të konstatuara. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP-së dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: "Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **K. Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A.**
- OE - **N.N. " Bli TERM "**
- Arkivës së OSHP-së: